

PROCESVERBAL
nga seanca e 43-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale mbajtur më 28.11.2022

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanovski.

Anëtarë në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishin: mr. Dragica Ljubevska, Shqipe Tahiri, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 43-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si në vijim:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 42-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 18.11.2022.
2. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJ Diber për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
3. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJ Diber për shkelje të nenit 98 paragrafi (1) të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJ Diber për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur.
5. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJ Diber për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.
6. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJ Diber për shkelje të nenit 14 të Ligjit për mediat.
7. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJ Kumanovë për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.
8. Të ndryshme.

Z.Petrushevski pas miratimit të Rendit të ditës, dha propozim që për Pikat nga 2 deri në 6 shërbimi të japë një hyrje të përbashkët pasi që bëhet fjalë për të njëjtin medium që ka shkelur disa nene të Ligjit, që Këshilli të ketë një diskutim dhe votimi të jetë për çdo shkelje në veçanti.

Anëtarët e Këshillit nuk ishin kundër këtij propozimi.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë pasi e shqyrtoi, miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 42-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 18.11.2022, me tekst si në vijim:.

Pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6

Udhëheqësja e Njesisë për mbikëqyrje programore dhe administrative Shqipe Tahiri i arsyetoj propozimet për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJ Dibrë për shkelje të neneve të LSHMAAV - 92 paragrafët (1) dhe (3), 98 paragrafi (1), 50 paragrafi (3) dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur, neni 51 paragrafi (1) dhe të nenit 14 të Ligjit për media. Ajo shpjegoj se këto shkelje janë konstatuar nga mbikëqyrja e zbatuar më 10 tetor të këtij viti. Në lidhje me nenin 98 shpjegoj se tek mediumi janë regjistruar transmetime të shpalljeve reklamuese që nuk janë të ndara qarta nga pjesët e tjera të programit me mjete optike dhe/ose sinjalizuese në fillim të bllokut reklamues. Shkelja e nenit 50 i referohet transmetimit të programit të bërë pa sinjalizimin adekuat paralajmërues para fillimit dhe pa shenjë klasifikuese për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes. Neni 51 paragrafi (1) ishte shkelur për shkak se më 10 tetor 2022, TV Dibra nuk i siguroj informacionet që duhet të jenë të (disponueshme)arritshme për (përdoruesit) shfrytëzuesit. Neni 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV i referohet mos transmetimit së paku 30% program i krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, edhe as së paku gjysmën e minimumit Ligjor program i krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që transmetohen në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00. Nga aspekti administrativ kemi shkelje të nenit 14 të Ligjit për mediat për shkak se në regjistrimin e ndeshjes së futbollit nuk ishin publikuar të dhënat për impresium (përshtypjet), që transmetuesi obligohet t'i transmetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Theksoi se shërbimi me personin përgjegjës të TV Dibrës ka realizuar kontakte dhe në të njëjtën kohë ka paraqitur deklaratë lidhur me shkeljen e konstatuar, me të cilat është në pajtim dhe i pranon ato. Njëkohësisht ai ka deklaruar se në afat të shkurtër do të korrigjohet dhe do të harmonizojë veprimtarinë e tij me Ligjin. Ajo po ashtu ka thënë se personi përgjegjës i TV Dibrës në lidhje me shkeljen e nenit 92 ka shpjeguar se televizioni po konfrontohet (ballafaqohet) me probleme financiare dhe nuk janë në gjendje të ofrojnë emisione të mjaftueshme të krijuara burimore si vepra audiovizuale maqedonase. Në këtë drejtim nga sektori i kanë sygjerruar t'i drejtohet Kinotekës së Maqedonisë së Veriut ku do të mund të siguroj emisione, për të përmbushur përqindjen ligjore të programit të krijuar burimor. Dhe në fund u shpreh se shpreson gjatë mbikëqyrjes së kontrollit mediumi do të mënjanojë këto shkelje, siç edhe u deklarua.

Z. Petrushevski tha se mediumit ju ofrua këshillë e mirë sa i përket marrjes me qira të emisioneve nga Kinoteka sepse vërtet televizionet po përballen me krizë financiare për të bërë

programe të (reja)tyre. Ai shpreson se transmetuesi do të pranoj sugjerimin dhe gjatë mbikëqyrjes së kontrollit këto shkelje do të mënjanohen.

Z. Ajdini tha se është mirë që transmetuesi është deklaruar lidhur me të gjitha shkeljet. Gjithashtu tha se është mirë që shërbimi programor e kontrollon personin përgjegjës Afrim Lela. Ajo që e përmendi drejtori Trajçevski në seancën e fundit është e vërtetë sepse duke përfshirë të gjitha mediat si ato rajonale dhe lokale monitorohen çdo 3 deri në 4 vjet, për këtë ato relaksohen dhe prandaj është ky problem me një numër të madh të shkeljeve të Ligjit. Ai deklaroi se do të mbështesë të gjitha propozimet për paralajmërime publike.

Z. Fidanovski pyeti nëse të gjitha këto shkelje të LSHMAAV dhe Ligjit për media janë konstatuar me një mbikëqyrje, për të cilën iu dha përgjigje pozitive.

Votimi sipas Pikës 2

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoj Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4069/1 datë 2.11.2022, njëzëri konkludoi se ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër t'i shqiptoj masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV për arsye se më 10 tetor 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as edhe të paktën e gjysmës së minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që e transmetonte në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike, të përgatisë aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Spektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimit e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas Pikës 3

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4079/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër duhet t'i shqiptojë masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 98 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse që nga 10 tetor 2022, është regjistruar transmetim i shpalljeve të reklamave që nuk janë të ndara qartë nga pjesë të tjera të programit me mjete optike dhe/ose zhurmuese në fillim të bllokut reklamues.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër, urdhërohet që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të

aktvendimit për shqiptim të masës paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike, të përgatisë aktvendimin për shqiptim të masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik, të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk vepron).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas Pikës 4

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoj Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4078/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër, t'i shqyrtoj masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur për shkak se më 10 tetor 2022, në TV-shoun real / kamera e fshehtë „Just for laughs - Gags“ është transmetuar pa sinjalizimin përkatës paralajmërues para fillimit dhe pa shenjë klasifikuese për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit për shqiptimin e masës paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike, duhet të përgatisë aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik, duhet të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) pas shqiptimit të masës ka vepruar (plotësisht, pjesërisht ose nuk vepron).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas Pikës 5

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, me nr.10-4091/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër t'i shqyrtoj masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV për arsyen se më 10 tetor 2022, nuk i siguroi informacionet që duhet të bëhen të arritshme për përdoruesit (shfrytëzuesit).

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmerrje të masës, me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015,

urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për shqiptim të masës paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e tij me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike, duhet të përgatisë aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik për transmetuesin e lartpërmendur.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik duhet të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk vepron).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmenduar ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas Pikës 6

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, me nr.10-4087/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër t'i shqiptoj masë paralajmërim publik, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për mediat, për arsyen se më 10 tetor 2022, në incizimin nga ndeshja e futbollit KS Korabi (Peshkopi) – KS Albpetrol (Patos), nuk janë publikuar të dhënat për impresium, që transmetuesi është i obliguar t'i transmeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje nga shërbimi programor.

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr. 01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për mediat.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike, të përgatisë aktvendimin për shqiptim të masës paralajmërim publik për transmetuesin e lartpërmendur.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Njesisë për çështje programore dhe mbikëqyrje administrative Shqipe Tahiri, e arsyetoi Propozimin për shqiptim të masës paralajmërim publik të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo sqaroi se më 10 tetor me mbikëqyrjen e rregullt në këtë medium është konstatuar se shërbimi programor i SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë nuk ka siguruar informacionet të cilat duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve. Po ashtu shpjegoi se kjo është një nga shkeljet më të shpeshta që e ndeshim tek transmetuesit, që siç thonë se ndodh për probleme teknike. Ky transmetues nuk ka dorëzuar deklaratë.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoj Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, me nr.10-4086/1 datë 2.11.2022 njëzëri konstatoi se SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë t'i shqiptoj masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV për arsye se në 10 tetor 2022 nuk ka siguruar informacione që duhet të bëhen të disponueshme (arritshme) për përdoruesit.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për shqiptimin e masës paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e tij me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike, të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimi e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-4383/8

05.12.2022

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v